

**Përkufizimi:**

Fjala arabe *?auf ???*( në shqip domethënë *frikë*. *Frika* është një ndjenjë shqetësimi që na ndodh kur mendojmë se do të na godasë ndonjë e keqe, fatkeqësi a dëm.

**Llojet e frikës:**

**1. Shirk i madh (??? ?????):**

Kjo është frika e fshehtë, e cila në arabisht quhet *?auf'us-sirr (??? ??????)*: Kjo është kur njeriu frikësohet nga dikush tjetër pos Allahut për gjërat që nuk mund t'i bëjë askush pos Allahut.

Argument për këtë është thënia e Allahut:

?  
???????

?

**(Ju mos iu frikësoni atyre, por frikësohuni prej Meje, nëse jeni besimtarë!)[1]**

**2. Haram, e ndaluar (?????):**

Kjo është frika që ndikon në lënien e ndonjë detyre ndaj Allahut a në bërjen e ndonjë mëkati.

Argument për këtë është thënia e Allahut:

??  
???

**(Prandaj, mos kini frikë nga njerëzit, por kini frikë vetëm prej Meje!)[2]**

### **3. E lejuar (????):**

Kjo është frika e natyrshme, siç është frika nga luani, nga armiku, nga sundimtari zullumqar, e kështu me radhë.

Argument për këtë është thënia e Allahut:

??  
? ? ? ??

**(Teksa (Musai) ecte në mëngjes i frikësuar në qytet, duke pritur se ç'do të ndodhte...)[3]**

### **4. Ibadet (?????):**

Kjo është frika vetëm nga Allahu, i Cili nuk ka ortak.

Argument për këtë është thënia e Allahut:

?  
? ? ? ???

?

**(Për ata që i frikësohen paraqitjes para Zotit të vet, do të ketë dy kopshte!)[4]**

## **Llojet e frikës nga Allahu:**

### **1. Frikë e lavdëruar:**

Kjo është frika që të pengon t'i bësh mëkat Allahut; të shtyn t'i kryesh detyrat ndaj Allahut dhe t'i lësh gjërat që i ka ndaluar Ai.

### **2. Frikë e përbuzur:**

Kjo është frika që e çon robin në humbjen e shpresave nga mëshira e Allahut.

---

[1] Sureja al-'imran, 175.

[2] Sureja el-maide, 44.

[3] Sureja el-kasas, 18.

[4] Sureja er-Rrahman, 46.